



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLIA-MINISTRY OF HEALTH			
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	09	Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No	05-4478
Nr.l faqeve Br.stranica No.pages	-05-	Datuz: Date:	24.02.2023
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

KONTRATË PUBLIKE

FURNIZIM

Titulli: "Furnizim me material elektrik dhe sanitar për nevojat e Instituti
Special Shtime-ISSH"

Numri i kontratës ¹: 206-23-5993-1-3-6/C324

Numri i Prokurimit: 206-23-5993-1-3-6

Operatori ekonomik: **LALITA GROUP SH.P.K.**

NUI: 811862061

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëzën anë;

dhe

LALITA GROUP SH.P.K., Lipjan, Lipjan, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me material elektrik dhe sanitar për nevojat e Institutit Special Shtime-ISSH me numër identifikues: 206-23-5993-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Furnizim me material elektrik dhe sanitar për nevojat e Institutit Special Shtime-ISSH

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin nga të dyja palët dhe përfundon pas kryerjes së furnizimeve.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhërësës nga AK

1.4 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: Institutit Special në Shtime.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP (Detyra e Dërguar e Paguar).

Nr. Art	Emertimi i Artikullit	Njësia	Sasia	ÇMIMI PËR NJËSI PA TVSH €	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	Pompe Uji zhytëse(Nivelet e shpejtesise:3, Materiali: Gize/ plastike, fuqia 75W; Diametri Ø 40 cm, Tensioni 230 V)	Copë	1	150	18	177.00 €	177.00 €
2	Ventil 3/4	Copë	3	3.5	18	4.13 €	12.39 €
3	Gyp fleksibil per kazana dhe shole	Copë	10	1.5	18	1.77 €	17.70 €
4	Qeshme të gjata për enëlarse me dy ujna (Ftoht dhe nxeht)	Copë	4	8	18	9.44 €	37.76 €
5	Qeshme të gjata me një ujë (vetem uj te ftoft)	Copë	5	8	18	9.44 €	47.20 €
6	Bateri (qeshme) lavamani	Copë	10	8	18	9.44 €	94.40 €
7	Qeshme e thjesht për oborr 3/4	Copë	10	2.5	18	2.95 €	29.50 €
8	Ndërprerës modular për drita 16A	Copë	20	1.8	18	2.124 €	42.48 €
9	Ndërprerës modular për bojler 20A	Copë	10	2.5	18	2.95 €	29.50 €
10	Poqa led 18w	Copë	15	1.4	18	1.652 €	24.78 €
11	Nxemsa të bojlerit -80lit. 2kw	Copë	8	8.5	18	10.03 €	80.24 €
12	Termostat bojleri	Copë	10	6.8	18	8.024 €	80.24 €
13	Brava komplet për dyer të plastikes me mekanizem	Copë	4	22	18	25.96 €	103.84 €
14	Brava të thjeshta për dyer të plastikes (Shin)	Copë	4	10	18	11.80 €	47.20 €
15	Drita led 60x60	Copë	5	10.5	18	12.39 €	61.95 €
Totali i përgjithshem:							866.18 €

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **866.18 €**; [*tetëqindegjashtëdhjetegjastë euro e tetëmbëdhjetë cent*].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 6 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Menaxheri i kontratës nga ISSH është: Gëzim Shabani

Telefoni: 049/347676





Personi kontaktues nga OE: Besim Sllamniku

Telefoni: 043/850-128; 046/129-186

E-mail: lalitagroup2@gmail.com

Për Autoritetin Kontraktues

Për Furnizuesin

Emri:	Berat Marmullaku	Emri:	Besim Sllamniku
Pozita:	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	Pozita:	PILONAIK
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.07.2023	Data:	24.07.2023
Vula:		Vula:	

²Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

811862061

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

LALITA GROUP SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

LALITA GROUP

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Društvo sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:

Rr - SHQIPRIA, pn
Lipjan


Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

21/09/2021

21/09/2021

Data / Date / Datum




Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10122082